REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY
Dep. DPK
Nr. Prot. 03-02/3600/17
Nr. i faq. 02
Data 02.11.2017
PRISHTINE

# Republika e Kosovës

## Republika Kosova - Republic of Kosova

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**
**ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 31.10.2017, mori:

## V E N D I M

**I. Mbyllet rasti** me *Nr.* ***AKK-03-02-2517-17, për Zyrtaren e lartë znj.Mirjeta Salihu– Këshilltare Komunale në Komunën e Vushtrrisë, për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.***

**II.** Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

## A r s y e t i m

**I.** Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me Nr. AKK-03-02-2517/17, për Zyrtaren e lartë, znj.Mirjeta Salihu, Këshilltare komunale në Kuvendin Komunal të Vushtrrisë, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznes privat, është trajtuar sipas procedurave të Ligjit për Parandalimin e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Fillimisht, Agjencia kundër Korrupsion i ka bërë shkresë njoftuese zyrtares së lartë znj.Mirjeta Salihu (DPK-03-02-2517-17), dhe pastaj ajo ka kontaktuar Agjencinë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të saj publik.

Zyrtarja e lartë, znj.Salihu është deklaruar se asaj se shpejti do t'i mbaroj mandati i të qenurit Këshilltare Komunale në Komunën e Vushtrrisë, por megjithatë ajo brenda afatit do të bëjë ndryshimet e nevojshme, dhe do të sjell informacionet në Agjenci.

Ndërkohë që, znj.Salihu, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka dërguar informacionet mbi ndryshimet në biznesin "Mirjeta Salihu" B.I. (DPK/Dpki-03-02/3564/17) të bëra në Agjensionin për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK), në të cilin shihet se, z.Mirjeta Salihu tashmë

ka hequr dorë nga funksioni menaxhues në këtë biznes privat, me çka ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

**II.** Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

/ Shaip Havolli /